VENDIM
Nr. 824, datë 19.12.2022

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI "RIKONSTRUKSION RRUGE NË LAGJEN '18 TETORI' DHE RIKONSTRUKSION I RRUGËS 'SALI GJUKA' (RIKUALIFIKIM URBAN I BLLOKUT TË BANIMIT NË LAGJEN '18 TETORI' DHE RIKONSTRUKSION I RRUGËS 'SALI GJUKA')"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Rikonstruksion rruge në lagjen '18 Tetori' dhe rikonstruksion i rrugës 'Sali Gjuka' (rikualifikim urban i bllokut të banimit në lagjen '18 Tetori' dhe rikonstruksion i rrugës 'Sali Gjuka')".
2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Dimal.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "truall" dhe "ndërtesë", me një vlerë të përgjithshme prej 752 735 (shtatëqind e pesëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 752 735 (shtatëqind e pesëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Dimal.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Dimal.
6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Dimal.
8. Bashkia Dimal kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Dimal.
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Dimal për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Dimal, sipas këtij vendimi.
12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Dimal, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURISË TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKONSTRUKSION RRUGE NË LAGJEN '18 TETORI' DHE RIKONSTRUKSION I RRUGËS 'SALI GJUKA' (RIKUALIFIKIM URBAN I BLLOKUT TË BANIMIT NË LAGJEN '18 TETORI' DHE RIKONSTRUKSION I RRUGËS 'SALI GJUKA')"

NR.	PRONARI			TË DHËNA KADASTRALE										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM											SHËNIME (kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)
														ARË			TRUALL			NDËRTESË			Vlerat e kultura bujqësore dhe dru-frutorëve sipas procesverbalit të Drejtorisë së Bujqësisë		VLERA TOTALE (lek)	
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m^2)	Truall (m^2)	Ndërtesë (m^2)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lek/m^2)	Vlera (lek)	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lek)	Vlera e kulturës bujqësore (lek)	Vlera e dru-frutorëve (lek)		
	A	B	C	C	Ç	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S	T	U	V	Y	Z
1	Rexhep	Avdulla	Korona	Ura Vajgurore	3682	2/591	Godinë	36		36	36	6	63			0	36	2375	85500	36		605624			691,124.00	Konfirmuar nga ASHK-ja, me urdhër nr. 21, datë 26.6.2013 kufizohet
2	Shkëlqim	Veiz	Plaku	Ura Vajgurore	3682	2/536	Garazh	15		15	15	5	71			0	3	2375	7125	15		54486			61,611.00	Konfirmuar nga ASHK-ja, me urdhër nr. 21, datë 26.6.2013 kufizohet
	Vlera totale															**0**			**92625**			**660110**			**752,735.00**	